

**V E N D I M**  
**PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK**

Sot ne date 15/12/2003 une **Blerina Muça**, Gjyqtare prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi studiova materialet e paraqitura nga kerkuesi **Foto Zeneli** per regjistrimin e shoqerise tregtare "**ALBANIA COURER SERVIS**" sh.p.k.

**K O N S T A T O V A**

Nga Foto Zeneli, ne cilesine e ortakut te vetem, eshte paraqitur kerkesa per regjistrimin e shoqerise tregtare "**ALBANIA COURER SERVIS**" sh.p.k. si person juridik.

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Kryerja e operacionit te transportit te shpejte te dokumentave COURER kolive dhe pakove brenda Shqiperise dhe jashte saj, me cdo lloj mjeti tokesor detar dhe ajror dhe kryerje sherbimesh te peraferta.

Standartizimi dhe paketimi i objekteve te vegjel.

Veprimtari transporti te çdo natyre me çfardo mjeti transporti.

Krijim agjensish automjetesh dhe i shoqerive te transportit, shoqerive ajrore, agjensive detare dhe te tjera te ngjashme me to, si dhe dhenja-marrja me qera dhe shfrytezim te automjeteve dhe anijeve, kryerje furnizimesh, zhdoganime mallrash.

Perfaqsimi ne Shqiperi i shoqerive te huaja dhe shqiptare dhe i ndermarjeve qe kane objekt te njejte apo te perafert dhe bashkepunimi me to ne çfardo lloj forme.

Organizimi i ndermarjeve tregtare realizimi i studimeve per çelje ekspozitash tregtare dhe reklamash ne pergjithesi.

Shfrytezimi i ndermarjeve hotelerie, turistike, dhe atyre te udhetimit ne pergjithesi.

Tregetim-riparim te matrialeve te telekomunikacionit.

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Bulevardi "Zogu i Pare", Nr.97.

Ortak i vetem i shoqerise eshte Foto Zeneli.

Administratore e jashteme e shoqerise do te jete Znj. Arta Maçi.

Kapitali themeltar eshte 100.000 leke.

Shoqeria do te vazhdoje veprimtarine e saj per nje afat mbi 10 vjet.

Nga sa me siper e konsideroj kerkesen te drejte dhe te mbeshtetur ne ligj.

### PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr.7638, date 19.12.1992 Per shoqerite tregetare dhe Ligjit Nr. 7667, date 18.01.1993 Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare,

### V E N D O S A :

Regjistrimin si person juridik te shoqerise "ALBANIA COURER SERVIS" sh.p.k

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Kryerja e operacionit te transportit te shpejte te dokumentave COURER kolive dhe pakove brenda Shqiperise dhe jashte saj, me cdo lloj mjeti tokesor detar dhe ajror dhe kryerje sherbimesh te peraferta.

Standartizimi dhe paketimi i objekteve te vegjel.

Veprimtari transporti te cdo natyre me cfardo mjeti transporti.

Krijim agjensish automjetesh dhe i shoqerive te transportit, shoqerive ajrore, agjensive detare dhe te tjera te ngjashme me to, si dhe dhenia-marrja me qera dhe shfrytezim te automjeteve dhe anijeve, kryerje fuirnazimesh, zhdoganime mallrash.

Perfaqsimi ne Shqiperi i shoqerive te huaja dhe shqiptare dhe i ndermarjeve qe kane objekt te njejte apo te perafert dhe bashkepunimi me to ne cfardo lloj forme.

Organizimi i ndermarjeve tregetare realizimi i studimeve per celje ekspozitash tregetare dhe reklamash ne pergjithesi.

Shfrytezimi i ndermarjeve hotelerie, turistike, dhe atyre te udhetimit ne pergjithesi.

Tregetim-riparim te materialeve te telekomunikacionit.

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Bulevardi "Zogu i Pare", Nr.97.

Ortak i vetem i shoqerise eshte Foto Zeneli.

Administratore e jashtme e shoqerise do te jete Znj. Arta Maçi.

Kapitali themeltar eshte 100.000 leke.

Shoqeria do te vazhdoje veprimtarine e saj per nje afat mbi 10 vjet.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne gjykatene Apelit.

**G J Y Q T A R E**

Blerina Muga

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

Nr. 12 Vendimi

V E N D I M  
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Sot me date 18/5 .2004 une gjyqtare L. Pajzaj prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, shqyrtova kerkesen dhe materialet e paraqitura nga kerkuesja Arta Maçi administratore e Shoqerise " Albania Courer Servis " Shpk, e cila kerkon depozitimim e dokumenteve per ndryshimin e emertimit, te adreses se selise te Shoqerise dhe regjistrimin ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, dhe

KONSTATOVA :

Se, Shoqeria " Albania Courer Servis " Shpk me vendimin nr.30672, date 15.12.2003 eshte regjistruar si person juridik ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Shkalles se pare Tirane, dhe Ortaku i vetem i kesaj Shoqerie z.Foto ZENELI, me vendimin Nr. 03, te dates 02.04.2004 ka vendosur :

1-Ndryshimin e emertimit te shoqerise nga " Albania Courer Servis " Shpk, ne " Albanian Courier Service " Shpk.

2-Ndryshimin e selise se shoqerise nga adresa : " Bulevardi " Zogu i Pare " Nr. 97 " ne adresen : " Rruga " Kajo Karafili ", Pallati 8 / 1 ".

Kerkesa e paraqitur eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare "; Nenet 24 dhe 33 te ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 " Per regjistrimin e shoqerive ne regjistrin tregtar "

VENDOSA:

-Pranimin e kerkeses.

-Depozitimim ne Zyren e Regjistrimit Tregtar te vendimit Nr. 03, date 02.04.2004 te Ortakut te vetem z.Foto Zeneli te kesaj shoqerie, e cila pas regjistrimit te ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar duke bere shenimet perkatese ne kolonen 2 ( a ) dhe ( b ) dhe kolonen 5 do te kete Emertimin : " ALBANIAN COURIER SERVICE " Shpk dhe Adrese : " Rruga " Kajo Karafili ", Pallati 8 / 1 ".

GJYQTARE

L. Pajzaj  
2004

VENDIM  
I GJYQTARIT TË VETEM

Ne Tirane, sot me date 29 Mars 2005, une Gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane,  
mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Foto Zeneli ortak i  
vetem i shoqerise "ALBANIAN COURIER SERVICE " shpk dhe ,

KONSTATOVA

Se shoqeria "ALBANIAN COURIER SERVICE " shpk, eshte regjistruar si person juridik me  
vendimin nr. 30672 date 15.12.2003, të Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me ortak te vetem  
Foto Zeneli dhe administratore znj. Arta Maçi.

Me vendimin nr. 1 date 03.01.2005 të Ortakut te Vetem te shoqerise eshte vendosur:

Lirimi nga detyra e administratorit te shoqerise te znj. Arta Maçi.

Emerimi ne detyren e administratorit te shoqerise te ortakut te vetem z. Foto Zeneli.

Nga shqyrtimi i akteve te paraqitura nga kerkuesi rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille  
duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje të ligjit 7667 date 28.01.1993 " Per Regjistrin Tregtar " dhe ligjit 7638 date  
19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare ",

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.


Depozitimim e vendimit nr. 1 date 03.01.2005 të Ortakut te Vetem te shoqerise sipas të cilit  
eshte vendosur :

Lirimi nga detyra e administratorit te shoqerise te znj. Arta Maçi.

Emerimi ne detyren e administratorit te shoqerise te ortakut te vetem z. Foto Zeneli.

Urdherohet Zyra e Regjistrin Tregtar të beje ndryshimet ne kollonat perkatese duke i ndare  
regjistrimet nga njeri tjetri me vije të kuqe.

GJYQTARE



Nr

Rregjistrimi .

30672

URDHER RREGJISTRIMI

Emri : "Albania Courier Service" shtet

Selia : Tirane, bulevardi "Topu i Ri" Nr 17.

Objekti: Transport i shtetit; dokumenteve pakor  
kredite e jehuti kredit, oficer ajror e shpallje  
shprehim - informim materiale telekomunikacionit etj.

Kapitali : 100.000 lekë

Ortakët : 100 %

Administrator: Arta Mas

Kohezgjatja : 10 vjet

Statuti : 6 f. 1 N

Akti i Themelimit : 37

Data e nenshkrimit te Statutit : 12.12.03

Data e Rregjistrimit ; 15.12.03

Shenime - Juris Nr 5526 dt. 04.12.03  
e SA. Transportit dhe Telekomunikacionit  
Treguesit Bankare e Alpha Bank.  
Nr llogj 020465011005398 dt. 20.11.03

GJYQTARE

BLERINA MECA





**AKT THEMELUES**  
**I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE "ALBANIA COURIER SERVIS"**  
**sh.p.k.**

Une Foto Zeneli i biri i Xhavitit, dhe i Saqinese, datl.1965, banues ne Tirane.

Mbeshtetur ne nenin 251, shkronja "c", te Ligjit Nr.7512 date 10.08.1991" Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit", krijoj shoqerine tregetare private me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "ALBANIA COURIER SERVIS" dhe me aktin themelues si vijon:

**F O R M I M I**

**NENI 1**

Formohet shoqeria tregetare private e quajtur "ALBANIA COURIER SERVIS" sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

**VEND-QENDRIMI I SHOQERISE**

**NENI 2**

Vend-qendrimi i shoqerise tregetare private "ALBANIA COURIER SERVIS" sh.p.k. do te jete ne Tirane, Bulevardi "Zogu i Pare", Nr.97. Shoqeria do te hap dhe vend-qendrimet te tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente dhe jashte vendit.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**


**NENI 3**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e: Kryerja e e operacionit te transportit te shpejte te dokumentave COURIER kolive dhe pakove brenda Shqiperise dhe jashte saj, me çdo lloj mjete tokesor detar dhe ajror dhe kryerje sherbimesh te peraferta.

Standartizimi dhe dhe paketimi i objekteve te vegjel.

Veprimtari transorti te çdo natyre dhe me çfardo mjete transporti.

Krijim agjensish automjetesh dhe i shoqerive te transportit, shoqerive ajrore, agjensive detare, dhe te tjera te ngjashme me to, si dhe dhenja - marrja me qera dhe



shfrytezim te automjeteve dhe anijeve, kryerje furnizimesh, zhdoganime mallrash.

Perfaqsimi ne Shqiperi i shoqerive te huaja dhe shqiptare dhe i ndermarjeve qe kane objekt te njejte apo te perafert dhe bashkepunimi me to ne cfardo lloj forme.

Organizimi i ndermarjeve tregetare realizimi i studimeve per celje ekspozitash tregetare dhe reklamash ne pergjithesi.

Shfrytezimi i ndermarjeve hotelerie, turistike dhe atyre te udhetimit ne pergjithesi.

Tregetim-riparim te materialeve te telekomunikacionit.

#### **NENI 4**

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi prodhimi, perpunimi, sherbimi tregetimi dhe do te bashkepusoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

#### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

#### **NENI 5**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pa caktuar dhe mbi 10 vjet.

Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku.

#### **KAPITALI I SHOQERISE**

#### **NENI 6**

Kapitali i shoqerise tregetare private "ALBANIA COURIER SERVIS " sh.p.k.do jete 100.000 leke dhe do te perbehet nga kuota e ortakut te shoqerise.

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te ortakut themelues. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

#### **NENI 7**

Ortaku i vetem duhet te beje perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruaje sekretin e saj dhe te mos demtoje interesat e personave te tjere dhe te shoqerise.

#### **DREJTIMI I SHOQERISE**

#### **NENI 8**

Shoqeria do te drejtohet nga administratore e jashteme e saj znj. Arta Maçi.

**NENI 9**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut themelues te shoqerise.

**NENI 10**

Ortaku themelues ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise. Ai ka te drejte te caktoje financier, likuidator per problemet e shoqerise, si dhe te pajtoje persona te tjere si ortatake Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare te tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

**NENI 11**

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

**NENI 12**

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme, me tekstin per rrethin e saj.

**NENI 13**

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Mbi krijimin e shoqerive tregetare".

**NENI 14**


Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kopetente

**NENI 15**

Akti i themelimit, u perpilua ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje do te mbetet dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private "ALBANIA COURIER SERVIS" sh.p.k. Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakut themelues

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE  
"ALBANIA COURIER SERVIS " sh.p.k**

Foto Zeneli





S T A T U T  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ALBANIA COURIER  
SERVIS "

Ne baze te Ligjit 7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit" dhe te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare", me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenshkrimin e Aktit Themelues:

Une Foto Zeneli i biri i Xhavitit, dhe i Saqinese, datl.1965, banues ne Tirane.

Hartoj statutin e shoqerise si me poshte:

**EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1**

Shoqeria emertohet "ALBANIA COURIER SERVIS "sh.p.k.

**NENI 2**

Selia e shoqerise tregetare private "ALBANIA COURIER SERVIS "sh.p.k.do te jete ne Tirane, Bulevardi "Zogu i Pare", Nr.97.

**NENI 3**

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregetar, prane Gjykates se rrethit Tirane.

**NENI 4**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e: Kryerja e e operacionit te transportit te shpejte te dokumentave COURIER kolive dhe pakove brenda Shqiperise dhe jashte saj, me çdo lloj mjeti tokesor detar dhe ajror dhe kryerje sherbimesh te peraferta.

Standartizimi dhe dhe paketimi i objekteve te vegjel.

Veprimtari transorti te çdo natyre dhe me çfardo mjeti transporti.

Krijim agjensish automjetesh dhe i shoqerive te transportit, shoqerive ajrore, agjensive detare, dhe te tjera te ngjashme me to, si dhe dhenja - marrja me qera dhe shfrytezim te automjeteve dhe anijeve, kryerje furnizimesh, zhdoganime mallrash.

Perfaqsimi ne Shqiperi i shoqerive te huaja dhe shqiptare dhe i ndermarjeve qe kane objekt te njejte apo te perafert dhe bashkepunimi me to ne çfardo lloj forme.

Organizimi i ndermarjeve tregtare realizimi i studimeve per çelje ekspozitash tregtare dhe reklamash ne pergjithesi.

Shfrytëzimi i ndermarjeve hotelerie, turistike dhe atyre te udhetimit ne pergjithesi.

Tregtim-riparim te materialeve te telekomunikacionit.

## KAPITALI I SHOQERISE

### NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise tregtare private "ALBANIA COURIER SERVIS" sh.p.k. do te jete 100.000 leke. Kapitali fillestar i shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit te ortakut themelues te shoqerise. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

### NENI 6

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te lujteshme ose te pa lujteshme etj, te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

### NENI 7

Kuota e kapitalit fillestar eshte dredhur nga ortaku themelues ne Banke, ne llogarine bankare te shoqerise, si edhe te regjistruara ne librin e llogarise te shoqerise.

### NENI 8

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, I takojne ortakut themelues, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

### NENI 9

Shoqeria tregtare "ALBANIA COURIER SERVIS" sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytëzoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republikën e Shqipërisë, Shoqëria tregëtare "ALBANIA COURIER SERVIS" sh.p.k. gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### NENI 10

Shoqëria tregëtare "ALBANIA COURIER SERVIS" vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimit vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku themelues i shoqërisë mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

#### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

#### NENI 11

Shoqëria do të drejtohet nga administratore e jashteme e saj, znj. Arta Maçi.

#### NENI 12

Hyjnë brenda detyrave dhe kompetencave të ortakut themelues si më poshtë:

- 1.Ndryshimi i aktit të themelimit dhe i statutit të shoqërisë.
- 2.Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve të administrimit, I inventareve dhe bilancit e llogarive vjetore.
- 3.Zgjedhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi i detyrave dhe i kompetencave të tyre, me përjashtim të atyre që shënohen në statut.
- 4.Aprovimi i garancive që ka shoqëria.
- 5.Miratimi i tarifave për shërbimet që kryen shoqëria.
- 6.Pranimet në punë dhe largimet nga puna.
- 7.Caktimi i formës së vules dalluese të shoqërisë.

Kryerja e të gjitha veprimeve të administrimit të Shoqërisë në emer, për llogari dhe për interes të saj.

#### NENI 13

Administratori jo ortak përveç detyrave që i caktojnë ortakët e shoqërisë ka edhe këto detyra e të tjera:

- 1.Te mirë-administrojë pasurinë e shoqërisë
- 2.Te bëjë marrveshje me të tretet brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kompetencave të caktuara nga ortakut themelues.
- 3.Te zbatojë rregulloren e brendshme të shoqërisë.

4. Te pergjigjet per demet qe i sjell Shoqerise nga veprimet e tij.
5. Te paguhet per punen qe kryen ne baze te merrveshjes se bere me ortakun themelues.
6. Te marre te dhena dhe te beje propozime pergjithçka qe e cmojn si te dobishme per shoqerine.
7. Te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne ne logjarine e shoqerise.

#### TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

##### NENI 14

Shoqeria ka te drejte:

1. Te kryeje veprimtari ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise.
2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke dhe ne valute nga Bankat vendase dhe te huaja ne baze te rregullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.
5. Te investoje kudo ne Shqiperi, nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj.
6. Te punesoje punetore te thjeshte ose te kualifikuar, vendas ose te huaj.
7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

##### NENI 15

Shoqeria ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne formen dhe kohen e duhur. Te jape garanci per sherbimet qe kryen shoqeria.
2. Te siguroje punonjesit e saj.
3. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo. Te respektojte standartet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

#### MARRDHENJET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

##### NENI 16

E gjithë veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

##### NENI 17

Ne seline e shoqerise mbahet dokumantacioni financiar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci.

**NENI 18**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

**NENI 19**

Shoqeria mban xhiro-llogarite ne Banke. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkatese.

**NENI 20**

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, shoqeria, pasi ben zbritjen e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5% te fitimit, me te cilin krijohet fondi

"Rezerve e domosdoshme", derisa ky fond te arrije masen 10% te kapitalit themeltar.

**NENI 21**

Te ardhurat neto, pas vecimit te fondeve te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, i mbesin ne perdorim ortakut themelues te shoqerise.

Konvertimi i parase te realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e shtetit Shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi i saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise

**DISPOZITA TE VECANTA**

**NENI 22**

Shoqeria ka vulen e vet dalluese.

**SHNDERRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE**

**NENI 23**

Shnderrimi i shoqerise "ALBANIA COURIER SERVICE" sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te ortakut themelues.

**NENI 24**

Shperberja e shoqerise, mund te vije ne cdo kohe dhe per cfar do shkak si :

- Humbja e kapitalit te shoqerise,
- Pamundesi veprimi,
- Me vendim te asamblese te ortakeve

Ne keto raste, pronari I shoqerise vendos mbi menyren e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke ju percaktuar dhe detyrat

Administratori dhe likuidatori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise perderi sa ajo t'u dorezohet personave perkates fizike e juridike, duke u likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria. Ne rast se fondet disponibel, rezultojene te pa mjaftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakut themelues te shoqerise qe te derdhe teresisht kuotat qe I takojne atij

#### DISPOZITA TE PERGJITESHME

##### NENI 25

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortaku themelues, si edhe ligjeve te veçanta te legjislacionit shqiptar.


Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne menyren dhe proceduren me te cilen nxirret vete statuti.

##### NENI 26

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare private "ALBANIA COURIER SERVIS" sh.p.k.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE  
"ALBANIA COURIER SERVIS" sh.p.k.

Foto Zeneli




REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA E TIRANES  
Nr. 4440 Rep.

V E R T E T I M

Noter me date 12.12.2003 u paraqit para meje znj. Foto Zeneli, madhor, i pa njohur personalisht prej meje, per identitetin e te cilit u njoha nga leternjoftimi perkates, i cili deklaroi se sa me siper eshte hartuar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe nenskruhet pa verjejtje ne pranine time dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTER

/ Nezir Murati /





# STATUT

## I SHOQERISE TREGETARE "Albanian Courier Service" sh.p.k.

"Ne baze te ligjit nr.7512, date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit", si dhe ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregëtare", me vullnetin e tij te lire, te shprehur ne nenshkrimin e ketij statuti dhe ne aktin e themelimit,

**z. Foto ZENELI**, i biri i Xhavitit dhe Seqinese, i datelindjes 1965, lindur dhe banues Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar

dhe

**Union Grup shpk**, Tirane regjistruar ne Regjistrin Tregëtar me nr. 26016 vendimi dt.25.06.2001, perfaqesuar nga administratori Niko LEKA

shpallin si vijon :

### **NENI 1 : EMRI, THEMELUESIT DHE VULA E SHOQERISE**

Shoqeria tregëtare do te emertohet "Albanian Courier Service sh.p.k." me ortake z.Foto Zeneli dhe shoqeria Union Grup shpk..Shoqeria ka simbolin dhe vulen e saj, qe permbajne geramat ACS sh.p.k. ne nje forme te stilizuar. Konfiguracioni i vules do te percaktohet nga administratori i saj, dhe mund te ndryshoje kohe pas kohe duke njoftuar paraprakisht ortaket e shoqerise.

Emri i plote i Shoqerise dhe adresa e qendres se saj duhet te perfshihet ne te gjitha aktet dhe dokumnetat e leshuar nga Shoqeria tek te tretet.

### **NENI 2 : FORMA JURIDIKE**

Shoqeria tregëtare "Albanian Courier Service" sh.p.k. eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin themeltar.

### **NENI 3 : SELIA**

Shoqeria e ka seline e saj ne rrugen " Kajo Karafili Pall 8/1 Tirane". Cdo ndryshim i selise do te behet me miratim te ortakeve te saj.Ajo mund te hape dhe seli te tjera te dyta, dege filiale, si dhe agjenci operative ne te gjithë



teritorin e R.SH. Me miratim te ortakeve dhe sipas legjislacionit ne fuqi ajo mund te hape jashte vendit perfaqesi, filiaiale ose dege te saj.

#### **NENI 4 : AFATI KOHOR**

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj ekonomike ne nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe per cfaredo shkak me vendimin e ortakeve qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar te Shoqerise.

#### **NENI 5 : OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise se Albanian Courier Service. sh.p.k. do te jete:



- a) Kryerja e operacionit te transportit te shpejte te dokumentave Courier, kolive dhe pakove brenda Shqiperise dhe jashte saj, me cdo lloj mjete tokesor, detar dhe ajeror dhe kryerje sherbimesh te peraferta.
- b) Standartizimi dhe paketimi i objekteve te vegjel.
- c) Veprimtari transporti te cdo natyre dhe me cfaredo mjete transporti.
- d) Krijim agjensish automjetesh dhe i shoqerive te transportit, shoqerive ajerore, agjensive detare dhe te tjera te ngjashme me to si dhe dhenie marrja me qira dhe shfrytezim te automjeteve dhe anijeve, kryerje furnizimesh, zhdoganime mallrash.
- e) Perfaqesimi ne Shqiperi i shoqerive te huaja dhe shqiptare dhe i ndermarjeve qe kane objekt te njejte apo te perafert dhe bashkepunimi me to ne cfaredo lloj forme.
- e) Organizimi i ndermarjeve tregtare, realizimi i studimeve per celje ekspozitash tregtare dhe reklamash ne pergjithesi.
- f) Shfrytezimi i ndermarjeve hotelerie, turistike dhe atyre te udhetimit ne pergjithesi.
- g) Tregetim riparim te materialeve te telekomunikacionit.

#### **NENI 6 : KAPITALI DHE NDRYSHIMET E TIJ**

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 250.000 (Dyqinepesdhjetemije) leke, i ndare ne 250 (dyqinepesdhjete) pjese, me vlere nominale 1000 lek secila, e perbere nga kontributi i ortakeve ne *cash* me perqindje per te dy ortaket si me poshte:

Foto ZENELI 40 % ose 100 (njqinte) pjese

Union Grup shpk 60 % ose 150 (njqintepesdhjete)



Kapitali themelues mund te ndryshoje sipas vendimit te ortakeve qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar te Shoqerise.. Kapitali i shoqerise mund te shtohet me mjete likuide ne llogarite e shoqerise ne bankat vendese ose ne asete te tjera lehtesisht te kthyeshme ne likuiditet.

#### **NENI 7 : ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT \***

Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet ose zvogelohet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve ne te cilen duhet te marrin pjese ortaket qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Cdo vendim per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit duhet te perfshije hollesi mbi afatet dhe menyren e pageses ose te zvogelimit te pjeseve te kapitalit.

#### **NENI 8 : TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR.\***

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet do te behet vetem me pelqimin me shkrim te te gjithe ortakeve te Shoqerise. Ky paragraf nuk zbatohet kur personi perfitues i transferimit eshte ortaku i shoqerise.


Ortaket kane te drejten e parablerjes se pjeses se kapitalit themeltar.

#### **NENI 9 : DISPONIMI I PASURISE**

Shoqeria tregtare "Albanian Courier Service sh.p.k." eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe mund te shfrytetoje te drejta te tjera materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten e shitjes se pasurise se vet tek te tretet. Ne Republiken e Shqiperise kjo shoqeri gezon te drejta si c'do person tjeter juridik shqipetar ose i huaj ne perputhje me legjislacionin shqipetar ne fuqi.

#### **NENI 10 : PERGJEGJESIA E ORTAKEVE**

Shoqeria tregtare "Albanian Courier Service sh.p.k." vepron ne regjistrin e prones dhe merr persiper te drejta dhe detyrime vetem brenda kapitalit te saj. Ortaket e shoqerise mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.



## **NENI 11 : ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE**

Organet drejtuese te shoqerise do te jene: ASAMBLEJA E ORTAKEVE DHE ADMINISTRATORI. Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese do te rregullohen sipas neneve te meposhtne te ketij statuti.

## **NENI 12 ASAMBLEJA E ORTAKEVE :**

Asambleja e Ortakeve perbehet nga te dy ortaket e Shoqerise .

12.1 Ortaku ka te drejte te njihen ne cdo kohe me te gjithe dokumentacionin qe disponon Shoqeria ne ushtrim te aktivitetit te saj dhe te hyje lirisht ne seline e shoqerise..

12.2 Ortaku ka te drejte te lajmerohet me poste ose faks te pakten 15 dite perpara mbledhjes se Asamblese. Njoftimi duhet te perbaje sakte rendin e dites, dokumentacion e pergatitur per tu shqyrtuar si edhe vendin ku do te kryhet mbledhja. Lajmerimi behet nga administratori ose eksperti kontabel i autorizuar. Ortaket nuk jane te detyruar te marrin ne shqyrtim ceshtje per te cilat nuk jane te njoftuar. Mosdhenia e njoftimit per Mbledhjen e Ortakeve e ben te pa vlefshem cdo vendim te marre ne nje mbledhje te tille.

12.3 Ortaket mund te lajmerohen edhe me vone se afati percaktuar me lart per ceshtje te karakterit urgjent, zgjidhja e te cilit i nenshtrohet vendimit te Asamblese. Ne kete rast mbledhja nuk anulohet kur te gjithe ortaket jene prezent personalisht ose nepermjet perfaqesimit me ane te prokures.



12.4 Ortaket kane te drejte te autorizojne njeri tjetrin ose persona te tjere per t'i perfaqesuar ne mbledhjen e Asamblese.

## **Neni 13 : MBLEDHJA E ORTAKEVE**

13.1. Mbledhja e ortakeve mbahet ne :

- Seline e Shoqerise
- Ne nje vend tjetër njoftuar ne lajmerim dhe te pranuar nga ortaket
- Me vendim qarkullues, pervec vendimit qe miraton bilancin, destinacionit te fitimit dhe ndryshimin e statutit i cili kerkon prezencen fizike te ortakeve

13.2 Cdo ortak qe perfaqeson te pakten 10 % te kapitalit themeltar te shoqerise ka te drejte te kerkoje mbledhjen e asamblese, duke percaktuar njekohesisht edhe rendin e dites.



13.3 Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

13.4 Per cdo Mbledhje te Ortakeve procesverbali i mbajtur duhet te jape hollesi mbi ceshtjet e meposhtme :

- Daten, vendin dhe natyren e mbledhjes
- Procedura e perdorur per te therritur mbledhjen
- Rendin e dites
- Emrat e ortakeve pjesmarres
- Nese eshte arritur kuorumi i nevojshem
- Diskutimet e mbajtuara ne mbledhje
- Vendimi i Asamblese
- Rezultatet e Vendimit

13.5 Mbledhja e ortakeve mund te drejtohet nga administratori ose ortaku me i vjeter ne moshe.

13.6 Procesverbali i Mbledhjes mbahet nga administratori dhe pas zbardhjes nenshkruset nga te gjithe ortakët.

#### **Neni 14 : KOMPETENCA E ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

1. Miratimi i bilancit te shoqerise.
2. Miratimi i destinacionit te shoqerise
3. Ndryshimin e kapitalit
4. Shtimin e objektit te aktivitetit te shoqerise
5. Blerje – shitje te objekteve te patundshme per llogari te Shoqerise
6. Miratimin e marrjes se kredise nga Bankat e nivelit te dyte dhe te dhenies se garancise per garantimin e kredise.
7. Miratimin e operacioneve mbi 10.000 EUR ose ekuivalentet e saj ne LEKE.
8. Ndryshimin e statutit
9. Emerimi i Ekspertit Kontabel
10. Miratimin e shperblimit te administratoreve
11. Hapjen e zyrave te perfaqesimit, filialeve ose degeve te tjera te shoqerise brenda e jashte vendit.
12. Miratimin e vleresimeve te eksperteve mbi kontributet ne natyre te kapitalit statutor.
13. Emerimin e Administratorit
14. Emerimin e likuidatorit
15. Miratimin e shkrirjes, bashkimit, likuidimit e shoqerise.
16. Miratimin e krijimit, perdorimit, shperndarjes se rezervave te Shoqerise
17. Emeron perfaqesues ad hoc ne rast te verifikimit te pikes 16.5 te statutit

## **NENI 15 : VENDIMI I ASAMBLESE**



- 15.1 Votimet qe lidhen me pikat 1, 2, 4, 5, 6, 7, 9,10,11,12,13,14, 17 kerkojne shumice 50 + 1 te ortakeve qe perfaqesojne kapitalin themeltar. Ne rast se nuk arrihet te sigurohet kjo shumice mbledhja e ortakeve perseritet pas 15 diteve dhe vendimi merret me shumicen e votave te dhena, pavarsisht nga perqindja e kapitalit qe perfaqeson.
- 15.2 Votimet qe lidhen me pikat 3, 8, 15, 16 kerkojne votimin e ortakeve qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar te Shoqerise.

## **Neni 16 : ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

- 16.1. Administrimi i shoqerise "Albanian Courier Service" sh.p.k. do te behet nga z. Foto ZENELI, Administrator i shoqerise .
- 16.2. Adminstratori i Shoqerise zgjidhet per nje afat kohor 3 vjecar. Ai mund te riemerohet perseri nga Asambleja e Ortakeve.
- 16.3 Administratori sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise ekonomike e financiare puneson persona te ndryshem. Rregullat e marrjes ne pune do te percaktohen me nje rregullore te vecante qe do te pregatitet nga administratori dhe miratohet nga mbledhja e themeluesve brenda tre muajve nga data e regjistrimit.
- 16.4 Administratori perfaqeson Shoqerine tek personat e trete dhe kryen cdo veprim administrimi qe nuk i perket ortakeve. Ortaket mund ti delegojne kompetenca e tyre administratorit i cili eshte i detyruar te kryeje veprimet konform autorizimit perkates.
- 16.5. Administratori nuk mund te operojne me llogarite e Shoqerise ne Bankat e nivelit te dyte kur atyre u eshte kerkuar doreheqja nga ortaket qe perfaqesojne 50+1 te kapitalit themeltar.

## **16.6. MBARIMI I MANDATIT TE ADMINISTRATORIT**

1. Mbaron afatin e percaktuar ne piken 16.2
2. Shkarkohet per shkaqe te arsyeshme nga Asambleja e Ortakeve
3. Jep doreheqjen
4. Arsytet shendetesore nuk i lejojne kryerjen e detyres se tij funksionale



## **NENI 17 RREGJISTRIMI NE AUTORITET PERKATESE**

Shoqëria tregëtare "Albanian Courier Service sh.p.k." deklarohet e krijuar me zbatim të plotë të normave që përmban ky statut dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Ajo fiton zotesinë e saj për të vepruar me regjistrimin e saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe ushtron veprimtarinë ekonomike me regjistrimin në organin përkatës tatimor.

## **NENI 18 PUNESIMI**

Mardhëniet e punës Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat e punësimit në R.SH. dhe sig. shoqërore, ndërsa të gjithë të punësuarit janë të detyruar të pranojnë statutin e shoqërisë. Mardhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk rregullohen në këtë kontratë zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Mosmarveshjet e punonjësve me shoqërinë do të zgjidhen në gjykatën shqiptare. Punonjësit e emeruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit të realizuar nga shoqëria gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, nëse në kontratë nuk është parashikuar ndryshe. Për punën e kryer punonjësit marrin pagë siç është parashikuar në kontratë.

## **NENI 19 MBYLLJA E BILANCIT**

Bilanci dhe të ardhurat Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisin në Janar dhe do të mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe ushtrimore bilanci kontabel mbyllet sipas ligjeve në fuqi. Bilanci kontabel i nënshtrohet miratimit të ortakeve .

## **NENI 20 DISPOZITA TE TJERA**

Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësisht që do të bëjë administratori si dhe ligjeve të vecanta të legjislacionit shqiptar. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti behen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxirret vetë statuti.

Ky statut përpilohet në disa kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente si dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të kësaj shoqërie. Statuti miratohet nga ortaket nënshkruhen nga ata rregullisht.

ORTAKET

Foto ZENELI


UNION GRUP sh.p.k.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA

Nr. 371P Rep.

Nr. 2385 Kol.



VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne daten 23 Korrik 2007 ( dymije e shtate), ditën e hene, une notere Eriketa Kokoli, notere ne Tirane, me Selh ne Rrugen “ Sami Frasheri” vertetova firmat e vena ne Statutin e Shoqerise “ Albanian Courier Service” te:

**1- Union Grup SHPK, perfaqesuar nga Niko Leka, I biri I Vlashit dhe I Margarites, lindur ne Tirane me 31 Mars 1961, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike, mbajtes I pasaportes me numer Z 0229907**

**2- Foto Zeneli, i biri i Xhavitit, lindur ne 1965, banues ne Tirane, madhor dhe me zoteis te plote juridike, mbajte si pasaportes me numer Z 1355632.**

Une noteri pasi e gjeta conform nenit 39 te Ligjes 7929 date 1 Qershor 1994 “ Per Noterine” e vertetova si me poshte.

NOTER  
Eriketa Kokoli

AKT-MARREVESHJE

Sot, me date 23.04 2007, ne Tirane, u paraqiten perpara meje notere Luçete Kull, anetare e Dhomes se Notereve, ne Tirane, palet qe do te lidhin kete kontrate:

Albanian Courier Service sh.p.k., rregjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane me Vendimin nr.30672, date 15/12/2003 ndryshuar me Vendimin 30672/1 date 17/05/2004 (me poshte referuar si "ACS"), me adrese Rruga Kajo Karafili Pall.8/1 Tirane, perfaqesuar nga Z. Foto Zeneli lindur me vitin 1965, ne qytetin e Vlores, i biri i Xhavitit dhe Saqinesë, banues ne Tirane person madhor me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr Z 1355632, banues ne Tirane, Shqiperi, referuar me poshte edhe si "Garantuesi"

dhe

Union Grup sh.p.k., me qender ne Bulevardin Zogu I, Pallati Edi-Com 13 Katesh, Tirane, Shqiperi, regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane me Vendimin nr. 26016, date 25/06/2001 e perfaqesuar nga Z. Niko Leka ne cilesine e Administratorit te shoqerise.

Deklarimet Paraprake

- 1) Z. Foto Zeneli eshte Ortak i Vetem ne shoqerine "Albanian Courier Service" Sh.p.k. dhe zoteron 100% te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren totale prej 100.000 (njqind mije) Leke. Ne cilesine e Ortakut te Vetem ka vendosur zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise "Albanian Courier Service" sh.p.k me shumen prej 150.000 Leke nepermjet nenshkrimt të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para (Njqintepesedhjetemije leke) duke e cuar keshtu kapitalin themeltar te ACS ne 250.000 (Dyqintepesedhjetemije leke) Leke ,
- 2) Union Grup sh.p.k. do te kontribuoje ne kapitalin themeltar te shoqerise ACS nepermjet kontributit ne para ne vleren nominale 150.000 leke (Njqintepesedhjetemije leke), si edhe nje prim mbi kapitalin ne vleren e 10.150.000 Leke (Dhjetemilione njqintepesedhjetemije leke).
- 3) Z. Foto Zeneli ka vendosur ne Vendimin nr. 2007/1 date 12 Korrik 2007 te Ortakut te Vetem, pranimin ne shoqeri te Union Grup Sh.p.k. nepermjet nenshkrimt te kuotave te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise duke pranuar qe Union Grup Sh.p.k. te nenshkruaje keto kuota .
- 4) Ne kushte te tilla Union Grup Sh.p.k. hyn ne shoqeri dhe zoteron ne te kuota te kapitalit themeltar te shtuar te



shoqerise nepermjet kontributit ne para, ne Shumen 150.000 Leke (njqinepesedhjetemije leke), duke zoteruar ne kete menyre 60% te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise



Deklarimet Paraprake jane pjese perberese e kesaj Marreveshje  
\*\*\*

Per sa me siper, ne baze te Ligjit Nr. 7638, date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare", palet bien dakord si me poshte:

#### NENI1

##### PERKUFIZIME

Ne vijim te termave te tjera te perkufizuara ne kete Marreveshje dhe me kete qellim, fjalet dhe termat e meposhtme do te kene kudo kuptimin qe jepet me poshte: "


"Mbyllje" kupton kalimin e zoterimit te pjeseve te kapitalit themeltar te shtuar, regjistrimin e Union Grup sh.p.k.si ortak te ri, dhe ne pergjithesi nenshkrimi dhe shkembimi i te gjithë dokumenteve dhe kryerjen dhe permbushjen e te gjithë detyrimeve, te kerkuara respektivisht per t'u nenshkruar dhe shkembyer, kryer dhe permbushur ne Mbyllje ne vijim te kesaj Marreveshje, ne menyre qe te legjitimoje Union Grup sh.p.k. si pronar te ri legjitim te 60% te pjeseve te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise ACS; Ne mbyllje Z. Foto Zeneli do te zoteroje 40% te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise ACS

"Barre" do te thote cdo garanci, kapar, peng, interesa sigurimi te cdo lloji, kufizim, e drejta per refuzimin e pare, e drejta e parablerjes, e drejte ose interes e nje pale te trete, hipoteke ose cdo lloj tjeter rregullimi preferencial(duke perfshire pa asnje kufizim, transferimin e nje titulli ose te nje marreveshje mbajtje), qe ka efekt te ngjashem ;

"Pale" ose "Palet" do te thote ACS, Z.Foto Zeneli, Union Grup Sh.p.k. ose te tre palet se bashku sipas kontekstit:

"Pjese te kapitali themeltar te shtuar" do te thote numer pjesesh 250 (dyqintepesedhjetete), te paguara plotesisht, te shlyeshme dhe te neshkrueshme teresisht te shoqerise me nje vlere te barabarte me 1,000 leke secila, qe i korrespondon shumes 250.000 Leke (Dyqintepesedhjetemije leke).

"ACS" do te thote Albanian Courier Service sh.p.k. nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne adresen Bulevardi "Zogu i Pare", Nr. 97, Tirane Shqiperi.



Titullit ne kete Marreveshje nuk influencojne ne interpretimin e

#### Neni 2 - Objekti

Duke pranuar termat dhe kushtet e kesaj Marreveshje, ACS perfaqesuar nga Z. Foto Zeneli ne cilesine e ortakut te vetem pranon ne shoqeri Union Grup Sh.p.k. dhe Union Grup Sh.p.k. do te marre ne zoterim, 60% te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Albanian Courier Service" Sh.p.k. dhe cdo te drejte qe rrjedh prej pjesemarrjes ne kapitalin themeltar te shoqerise, te lira nga cdo lloj Barre.

#### Neni 3 - Kontributi ne kapitalin themeltar te shoqerise dhe zmadhimi i kapitalit

Union Grup sh.p.k. do te kontribuojne ne kapitalin themeltar te shtuar te shoqerise ne shumen prej 150.000 leke (Njeqinpesedhjetemije leke) qe do te paguhet ne perputhje me dispozitat e parashikuara ketu dhe duke pranuar afatet dhe kushtet e kesaj Marreveshje.

Union Grup sh.p.k. do te paguaje gjithashtu edhe nje prim mbi kapitalin ne shumen e 10.150.000 Leke (Dhjetemilioneqintepesedhjetemije leke). Totali perben vleren e 60% te pjeseve te kapitalit te shtuar te ACS qe shlyhen nga ortaku i ri Union Grup sh.p.k.

Ne daten e Mbylljes, shumat prej; 150.000 (Njeqintepesedhjetemije leke) si pjese e kapitalit themeltar te shtuar te ACS dhe 10.150.000 Leke (Dhjetemilioneqintepesedhjetemije leke) si prim mbi kapitalin do te kalojne me transferte bankare ne llogarine rrjedhese te ACS ne Union Bank.

Ne perfundim, Union Grup do te zoteroje 60% te kapitalit themeltar te shtuar te ACS dhe z.Foto Zeneli do te zoteroje 40% te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise.

#### NENI 4 MBYLLJA

Ne Mbyllje

a. ACS do te :

1. Te nenshkruaje dhe te dorezoje, dhe/ose te beje te mundur nenshkrimin dhe dorezimin e dokumentave te tjera qe mund te nevojiten sipas legjislacionit shqiptar, per t'i dhene Union Grup Sh.p.k. titullin efektiv e ligjerisht te vlefshem per

zoterimin e 60% te kuotave te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise.

dhe

b. Union Grup Sh.p.k do te :

1. Derdhe kontributin prej 150.000 Leke (Njeqinteesedhjetemije leke) ne kapitalin themeltar te shtuar te shoqerise;
2. Derdhe primin mbi kapitalin prej 10.150.000 Leke (Dhjetemilionenjeqinteesedhjetemije leke)

Ne Mbyllje, Union Grup Sh.p.k. do te fitoje titujt e zoterimit te pjeseve te kapitalit themeltar te shtuar dhe te drejtat qe rrjedhin nga to ne Daten e Mbylljes dhe atij do t'i jepet e drejta per cdo dividend te deklaruar ose te paguar per to si dhe per te drejta te tjera lidhur me to, qe nga data 1 Qershor 2007.

#### **NENI 5 DEKLARIMET DHE GARANCITE E ACS dhe ORTAKUT TE VETEM**

ACS dhe Ortaku i Vetem Z. Foto Zeneli garanton se deklarimet e meposhtme jane te verteta.

ACS dhe Ortaku i Vetem deklararon dhe garanton lidhur me shoqerine Dhe veprimet e kryera ne kete marreveshje, secilen nga ceshtjet e meposhtme. Ortaku i vetem garanton gjithashtu se cdo deklarim apo garanci do te jete e vertete , e sakte dhe jo mashtruese ne Daten e Mbylljes.

Pavec kesaj Marreveshje nuk ekziston ndonje marreveshje tjeter e cila te detyroje Ortakun e Vetem per kalimin, transferimin e ketyre kuotave te kapitalit themeltar te shtuar ndonje pale te trete.



Ortaku i Vetem pranon qe pas zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise, Union Grup Sh.p.k. te zoteroje 60% te ketij kapitali si dhe te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga kjo, kurse Z. Foto Zeneli te zoteroje 40% te ketij kapitali si dhe te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga kjo.

#### **5.1. Organizimi**

Shoqeria eshte shoqeri ekzistuese, e organizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ajo nuk eshte ne falimentim dhe ka aftesi te plote te zhvilloje aktivitetin e saj si deri me sot si dhe te zoteroje aktivet dhe pasurite e saj sikurse i ka zoteruar deri me sot. Shoqeria operon me nje license te vlefshme, sic pershkruhet ne Aneksin D, dhe nuk ka shkelur asnje nga kushtet e licenses.

#### **5.2 Autorizimi**

Te gjitha veprimet ligjore dhe/ose procedurat e tjera qe kerkohet te ndermerren nga ose ne emer te ACS per ta autorizuar lidhjen dhe zbatimin e Marreveshjes per kuota te kapitalit themeltar te



shtuar e parashikuara ne ate, jane zhvilluar ne rregull;kjo Marreveshje eshte nenshkruar e dorezuar ne kohen e duhur nga ACS dhe perben nje detyrim te vlefshem e te detyrueshem te ACS, te zbatueshem ndaj tij , ne perputhje me termat dhe kushtet e saj.Zbatimi i kesaj Marreveshje nuk kerkon ndonje njoftim tjeter, ndonje plotesim, aprovim,autorizim te cfaredoshem nga ndonje autoritet publik kombetar ose nderkombetar ose qeveritar, rregullator apo autoritet tjeter.

#### 5.3 Mungesa e konfliktit

Zbatimi i kesaj Marreveshje ne pajtim me afatet, kushtet dhe klauzolat e saj,nga ACS, nuk kane qene e nuk do te jene ne konflikt me, ose te rezultojne me ndonje shkelje apo mangesi, apo te jape shkak per perfundimin , prishjen ose pershpjtimin e ndonje detyrimi ose humbjen e ndonje perfitimi material, ose te rezultojne me krijimin e ndonje barre ne ndonje nga aktivitetet ekonomike , pronat apo pasurite e ACS sipas ndonje dispozite, vendimi gjyqesor, urdherese , dekreti , rregulli ose rregulloreje te zbatueshme per ACS.

#### 5.4 Marreveshje te tjera

Nuk ka ndonje marreveshje, rregullim ose detyrim per te krijuar ose vene nje Barre, lidhur me ndonje nga Kuotat e kapitalit themeltar te shtuar e autorizuar por te pakryera ne kapitalin e Shoqerise. Asnje person nuk ka pretendim t'i jepet e drejta per ndonje Barre lidhur me ndonje nga Kuotat e kapitalit themeltar te shtuar.

Pervec sa parashikohet ne kete Marreveshje, nuk ka asnje marreveshje, rregullim ose detyrim qe te kerkoje transferimin e kuotave te kapitalit themeltar te shtuar (duke perfshire pa kufizim, nje mundesi ose te drejte per parablerje apo tjetersim)

#### 5.5.Shoqerite e ndervarura

Kjo shoqeri nuk ka ndonje shoqeri te ndervarur.

#### 5.6.Llogarite

**Llogarite financiare te ACS sipas Aneksit A te kesaj akt marreveshje tregojne nje paraqitje te vertete e transparente te aktiveve e pasiveve dhe gjendjen e aktivitetit te Shoqerise qe nga themelimi i ACS deri ne daten 31 Maj 2007 , si dhe humbjet e fitimet e shoqerise deri ne daten 31 maj 2007.**

Shoqeria nuk ka obligime, detyrime, borxhe dhe pergjithesisht risk material qe te mos jene deklaruar sic duhet ne llogarite ose qe lidhur me te jane shperndare fonde apo rezerva te pa arsyeshme.

#### 5.7 Regjistri i Kontabilitetit dhe librat e tjere te Shoqerise

Regjistrat dhe librat e shoqerise aktualisht jane ne posedim ose ne kontroll te saj, ato jane mbajtur ne rregull dhe te gjitha regjistrimet ne keto libra dhe regjistra jane hedhur sic duhet ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe standartet, parimet dhe praktikat e aplikueshme.



#### 5.8 Mungesa e Ndryshimeve Materiale

Biznesi i ACS eshte zhvilluar ne menyre te zakonshme e ne menyre te tille qe ta mbaje ate si ndermarrje fitimpruresse ; nuk ka ndodhur asnje ndryshim material ne aktivet e pasivet e treguara ne llogari, gjithashtu nuk ka ndodhur asnje reduktim te vleres se aktiveve neto te trupezuara te Kompanise mbi bazen e vleresimit te perdorur ne llogari.

Ne dijeni te plote te Z. Foto Zeneli, shoqeria eshte drejtuar e shfrytezuar sic duhet dhe Z. Foto Zeneli nuk ka dijeni qe eshte vete ai dhe/ose shoqeria :

- Ka hyre ne ndonje marreveshje, vlera e se ciles e kalon shumen prej 100.000 Leke (njeqintmije leke).
- ka ndodhur ndonje detyrim material, pergjegjesi materiale.
- Ka ndermarre ndonje veprim tjeter, i cili mund te shkaktoje qe ndonje nga deklarimet dhe garancite e Z. Foto Zeneli te perfshira ne Marreveshje, te behen jo te verteta ose jo korrekte.

Shoqeria qysh nga 31 Maj 2007 nuk ka :

a.) pesuar ndonje ndryshim material te aktiveve , pasurive apo veprimeve te biznesit

b.) pesuar ndonje ngjarje materiale ose rrethana qe lidhen me aktivet, biznesin ose pasurine dhe qe kercenojne te prishin materialisht, te parandalojne, te demtojne ose te ndikojne materialisht ne te kundert, ne rezultatin perfundimtar te kesaj marreveshje;


c.) hyre ne ndonje transaksion ose marreveshje, apo te kete ndryshuar ose perfunduar ndonje transaksion apo marreveshje qe ne menyre te arsyeshme mund te pritet qe te kete nje efekt material te kundert mbi asetet, pasurite, veprimtarine e biznesit te shoqerise.

d.) shitur, transferuar, lene peng, dhene me qira, ose thene ndryshe, nuk ka hequr te drejttat e pronesise mbi ndonje aktiv ose pasuri te zoteruar nga Shoqeria;;

e.) punesuar personel ose rritur shkallen e kompesimit te pagueshem ose qe behet i pagueshem per punonjesit me shume se rritja e bere ne pajtim me praktikat e kaluara qe konsiston ne ndonje kompensim ekzistues ose plane te tjera, ose ndryshuar organizimin e punes se tyre ne ndonje menyre materiale ;

f.) perfituar ndonje pronesi te paluajtshme ose te kete bere ndonje shpenzim te kapitalit (te trupezuar ose jo te trupezuar) qe e kalon vleren prej 100.000 Leke (Njeqintmije leke)

g.) perfituar ose shitur, ne ndonje forme, interesa ne kapital te shoqerive te tjera ose perfitim, shitje apo dhenie me qira (si qiradhenes apo si qiramares) ndonje veprimtari ekonomike apo pjese te kesaj veprimtarie ekonomike.



h.) deklaruar ose paguar ndonje dividend, ose blere ose te perfituar ndonje interes ne pasurine e tij .

i.) rene dakord formalisht per te bere ndonje nga sa eshte parashikuar.

Z. Foto Zeneli garanton se gjate zbatimit te kesaj marreveshje shoqeria nuk do te beje asnje shpenzim apo nuk do te marre persiper asnje detyrim pa marre me pare miratimin e Union Grup Sh.p.k.

#### 5.9.Taksat dhe Padite gjyqesore

Shoqeria ka renditur ne nje rend kohor, te gjitha te dhenat per taksat periodike dhe vjetore te parashikuara nga legjislacioni qe aplikon Shoqeria. Te dhena te tilla per taksat jane pergatitur ne menyre korrekte dhe te gjitha taksat direkte ose indirekte si dhe obligimet e tjera te percaktuara, jane paguar ne kohe dhe ne menyre te plote. Për sa më sipër është lëshuar nga autoritetet tatimore shqiptare një vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore ashtu siç tregohet në Aneksin F.

Nuk ka asnje ceshtje gjyqesore ne gjykim ose ndonje padi tjeter akuzuese, pervec atyre te referuara ne Aneksin G.

#### 5.10.Aktive te Trupezuara

Shoqeria ka titull pronesie te plote, efektiv, te vlefshem nga ana ligjore, pa ndonje detyrim ligjor, barre, a kufizime te tjera, mbi te gjitha aktivet dhe pronat e saj, sic jane te listuara ne Anekset H dhe I (duke perfshire pronen e paluajtshme ose te luajtshme) dhe ky titull nuk eshte objekt i ndonje kufizimi, pengu, hipoteke, a barre tjeter apo te drejte te cfaredolloji lidhur me perfitimin e paleve te treta.

#### 5.11.Aktive te Patrupezuara


Shoqeria ACS eshte pronari i vetem dhe ekskluziv i - ose ka te drejten te perdore- patenten, emrin e mire, marken e prodhimit, dhe ndonje te drejte pronesie tjeter industriale ose intelektuale te nevojshme, per te drejtuar aktivitetin e tij ekonomik, sic jane renditur ne aneksin J, dhe nuk ka kryer anje shkelje ne lidhje me patenten, emrin e mire, marken e prodhimit, dhe te ndonje te drejte tjeter pronesie industriale apo intelektuale.

Shoqeria eshte e licensuar plotesisht per perdorimin e software-t te saj.

Keto aktive te Patrupezuara jane plotesisht te perdorshme nga Shoqeria pa paguar ndonje takse per license, te drejte te autorit, ose te detyrimeve te tilla.

#### 5.12.Marreveshjet

Shoqeria nuk eshte pale ne ndonje marreveshje te shkruar qe nuk eshte ekzekutuar plotesisht, pervec atyre te deklaruar dhe te evidentuara prej Z. Foto Zeneli nepermjet dokumentacionit



bashkengjitur kesaj marreveshje, sic eshte e specifikuar ne **Aneksin L.**

#### 5.13. Punonjesit

Shoqeria nuk eshte dhe nuk ka qene ndonjehere pale ne ndonje marreveshje pune ose impenjimi per pune me ndonje pale te trete. Shoqeria nuk eshte pale me ndonje agjensi shitjesh, perqindjesh ose ne ndonje marreveshje konsulence.

Te gjitha te punesuarit jane te regjistruar ne regjistrin perkates se bashku me kompensimin teresor qe i paguhet secilit prej tyre, ne perputhje me ligjet dhe rregulloret perkatese te zbatueshme. **Lista e te punesuarve te shoqerise dhe pagat e tyre jane te listuara ne aneksin M te kesaj marreveshje.**

Shoqeria ka bere te gjitha renditjen, dhe ka ndermarre te gjitha veprimet e kerkuara per t'u kryer ose ndermarre, per aplikimin e sigurimeve sociale, te punes dhe te ligjeve dhe rregulloreve lidhur me mireqenien, duke respektuar secilin prej Punonjesve. Te gjitha sigurimet sociale dhe detyrimet lidhur me mireqenien te percaktuara nga keto ligje dhe rregullore, sikunder dhe ne marreveshjet kolektive nese ka te tilla, jane paguar teresisht.

#### 5.14. Pajtueshmeria me ligjin

Shoqeria e ka kryer aktivitetin e saj ekonomik ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe rregulloret perkatese te aplikueshme. Shoqeria zoteron te gjitha lejet materiale, licensat, dhe miratimet e tjera ose autorizimet e kerkuara per aplikimin e statutit, ligjeve, , rregullave, urdheresave, dekrete, ne lidhje me te drejten e pronesise, perdorimit, ruajtjes dhe veprimit te aktivitetit te saj ose te ndonje prej aktiveve dhe pronave ose te ndonje marreveshje dhe te drejte te ciles i drejtohet.

#### 5.15. Garancite, borxhet, rimbursimet

Shoqeria nuk ka ndonje detyrim te njohur dhe nuk ka miratuar krijimin e ndonje kapitali hua, te marre borxhe ose hua te kesaj natyre, pervec sa eshte raportuar ne **Aneksin N.**


Shoqeria nuk eshte pale, dhe nuk eshte e detyruar, ne ndonje garanci, detyrim per rimbursim ose te marreveshje tjeter qe siguron ose sjell detyrim financiar ose te ndonje lloji tjeter, ndaj nje pale te trete.

#### 5.16. Likuidimi, administrimi dhe shkrirja

Nuk eshte dhene asnje urdher, nuk eshte paraqitur ndonje petition ose te kete kaluar ndonje kerkese per likuidimin e Shoqerise ose per percaktimin e ndonje likuiduesi te perkohshem per shoqerine, dhe asnje urdher administrativ nuk ka dale per shoqerine; dhe kjo e fundit nuk eshte e paafte per te paguar borxhet e saj dhe nuk eshte ne procedure falimentimi

#### 5.17. Statuti

Z. Foto Zeneli garanton qe ne daten e mbylljes do te behen edhe ndryshimet ne Statutin e ACS sipas atij te percaktuar ne Aneksin



S qe i bashkangjitet dhe eshte pjese perberese e kesaj akt marreveshje.

#### **NENI 6 DEKLARIMET DHE GARANCITE E UNION GRUP SH.P.K.**

##### **6.1. Autorizimi**

Te gjitha aktet e perbashketa dhe/ose procedimet e tjera te kerkuara per t'u ndermarre prej ose ne emer te Union Grup Sh.p.k. per te autorizuar ate per te hyre dhe per t'iu permbajtur kesaj Marreveshje jane kryer plotesisht, kjo Marreveshje eshte ekzekutuar plotesisht dhe levruar prej Union Grup Sh.p.k. dhe perben nje detyrim lidhes per Union Grup Sh.p.k., te detyrueshem per t'u zbatuar prej tij, ne perputhje me termat dhe kushtet e saj.

Ekzekutimi i kesaj Marreveshje nuk do te rezultoje me ndonje shkelje te ndonje ligji ose dokumenti te Union Grup Sh.p.k. qe mund te ndikoje vlefshmerine ose detyrueshmerine e kesaj Marreveshje.

#### **NENI 7 KUSHTET PER MBYLLJEN**

Detyrimi i Union Grup Sh.p.k. per te kontribuar ne vleren nominale te kapitalit te shtuar te shoqerise ne shumen 150.000 Leke (Njeqintepesedhjetemije leke), si edhe primin mbi kapitalin ne vleren e 10.150.000 (Dhjetemilionenjeqintepesedhjetemije leke) dhe detyrimi i ACS per t'i kaluar Union Grup Sh.p.k. zoterimin e 60% te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise dhe te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga kjo, jane subjekt per pranimin ose heqjen dore ne, ose para, Dates 31 Korrik 2007 per kushtet e meposhtme :

##### **7.1. Asnje Urdher ose Ndalim**

Nuk do te kete efekt asnje ligj i aplikueshem ose urdher i shpallur, i miratuar , i imponuar, i dekretuar ose ndonje ndalim tjeter ligjor ose ndalim qe pengon ekzekutimin e kesaj marreveshje.

##### **7.2. (a) Deklarimet dhe Garancite.**

Deklarimet dhe garancite e ACS te bera ne kete Marreveshje duhet te jene te verteta dhe korrekte ne te gjitha aspektet materiale, si per daten e permendur ketu ashtu dhe pas Mbylljes


##### **(b) Kryerja e Detyrimeve te ACS.**

ACS duhet te kete kryer ose plotesuar ne te gjithe aspektet te gjitha detyrimet e kalimit te zoterimit te 60% te kapitalit themeltar te shtuar Union grup sh.p.k. te kerkuara nga kjo Marreveshje ose qe duhen plotesuar dhe kryer nga ACS ne kohen e Mbylljes.

##### **(C) Mungesa e Procedurave**

Ne kohen e Mbylljes, nuk do te kete ceshtje te pazgjidhura:

- i) kundersiztimimi ose perpjekje per te penguar ose ndaluar





FIRI

- ii) perpjekje per te ndaluar ose kufizuar pronesine ose veprimet e kompanise ne ndonje pjese te veprimtarise se saj ekonomike ose te aktiveve te Kompanise
- iii) perpjekje per te imponuar kufizime ne kompetencat e Union Grup Sh.p.k. per te marre ose mbajtur , ose te ushtroje te drejta te plota te pronesise qe rrjedhin nga zoterimi i 60% te kapitalit themeltar te shtuar te kompanise.
- iv) perpjekje per t'i ndaluar Union Grup Sh.p.k. te kete zoterimin efektiv ne Kompani te 60% te kapitalit themeltar te shtuar ; me kusht qe, megjithate, ky kusht te parashikohet prej Union Grup Sh.p.k. per te hequr dore per ndonje veprim, procedim, kerkese padi pervec ndonje padie, veprimi a procedure te ndonje enti qeveritar) ne qofte se ACS i siguron Union Grup Sh.p.k. demshperblim ne forme dhe permbajtje, ne thelb te kenaqshme per Union Grup Sh.p.k. persa i perket kerkesave te tilla, veprimeve ose procedimeve.

(b) Kryerja e Detyrimeve te Union Grup Sh.p.k.  
Union Grup Sh.p.k. duhet te kryeje dhe te permbushe te gjitha detyrimet materiale te kerkuara ne kete Marreveshje per t'u kryer ose permbushur ne kohen e Mbylljes.

#### NENI 8 DEMSHPERBLIMET PREJ ACS

##### 8.1. Pergjegjesia e ACS

ACS eshte dakord ta quaje Union Grup Sh.p.k., sipas rastit, te pafajshem dhe te demshperblyer, sipas kushteve dhe brenda limiteve te rena dakord me poshte, per ndonje Humbje qe rrjedh prej ose varet nga fakte dhe rrethana te ndodhura ose te hasura para Dates mbylljes, edhe nese Humbja rezulton pas kesaj date.

##### 8.2. Perjashtimet dhe Kufizimet


Detyrimi per zhdemtim i ACS do te hyje ne fuqi kur tere sasia e Humbjeve subjekt i kerkeses per zhdemtim te Union Grup Sh.p.k. ne teresi tejkalon Shumen prej 100.000 Leke (njqintmije leke), dhe parashikon qe, nese eshte tejkaluuar kufiri, ACS duhet te jete pergjegjes per te paguar vetem sasine e tejkaluuar.

ACS do te detyrohet te beje pagimin e Union Grup Sh.p.k. ose te shogerise bazuar ne kete nen, vetem ne qofte se dhe kur shoqeria te kete shkaktuar Humbjen ne fjale.

#### Neni 9



##### Garancite per pagimin e demit

1. Z. Foto Zeneli garanton se deklarimet e bera ne nenin 5 te kesaj Marreveshje jane te verteta. Ne rast te kundert, Union Grup Sh.p.k i lind e drejta te kerkoje deshperblim per demin e shkaktuar nga pavertetesia e deklarimeve te



bera ne nenin 5. Per te garantuar Union Grup sh.p.k. per pagimin e demshperblimit, Z. Foto Zeneli pranon te ngarkoje me barre siguruese ne favor te Union Grup Sh.p.k., pjesen e tij zoteruese prej 40% te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Albanian Courier Service" Sh.p.k. e regjistruar si person juridik ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tiranë me vendimin numër 30672, date 15/12/2003, ndryshuar me vendimin 30672/1 date 17/05/2004. (shih bashkangjitur Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar)

2. Z. Foto Zeneli , i njohur ligjerisht si zoterues i 40% te pjeseve te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise, duhet t'a regjistroje pjesen e tij zoteruese te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise ne Regjistrin e Barreve Siguruese sipas procedurave ligjore ne fuqi, ne perputhje me kerkesat e paragrafit te mesiperm te ciluar nga cdo barre apo detyrim tjeter ndaj ndonje pale te trete.
3. Ne cilesine e barredhenesit, Z. Foto Zeneli, do te depozitoje prane Regjistrimit Tregtar vendimin perkates te asamblese per ngarkimin e kesaj pasurie me barre shoqeruar edhe me nje kopje origjinale te kesaj Marreveshje;
4. Ne cilesine e barredhenesit Z. Foto Zeneli detyrohet te mos kryejë asnjë procedurë apo veprim për kalimin ose tjetersimin e të drejtave të pronësisë, mbi pasurine e ngarkuar me barre apo cdo pasuri tjeter e lidhur me te , plotesisht ose pjeserisht, nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate dhe pa miratimin paraprak me shkrim nga ana e Union Grup Sh.p.k.
5. Në rast se Z. Foto Zeneli nuk e paguan demshperblimin per demin e shkatuar si rezultat i deklarimeve te paverteta te bera ne nenin 5 , atëherë Union Grup sh.p.k. fiton të gjitha të drejtat për të proceduar menjehere për fitimin e pronësisë mbi pasuritë e ngarkuara me barre, në përputhje me dispozitat e kesaj marreveshje qe perben titull ekzekutiv sipas nenit 510 e vijues te Kodit te Procedures Civile te Republikës se Shqipërisë dhe nenit 605 te Kodit Civil te Republikës se Shqipërisë.
6. Union Grup Sh.p.k. ose perfaqesuesi i saj ka të drejtë të bëjnë kqyrjen e pasurise se vendosur si barre siguruese dhe të bëjnë të gjitha verifikimet perkatëse në lidhje me gjendjen e tyre në vend e në regjistrat perkates.
7. Në qoftë se për cfarëdo shkak mbi një pjesë ose mbi të gjitha pasurinë e regjistruara me barre siguruese tagrat e pronësisë janë cënuar, shitur ose transferuar pa pëlqimin e shprehur me shkrim të Union Grup sh.p.k., ky i fundit ka të drejtë të kërkoje në mënyrë të menjëhershme kthimin e pasurise se ngarkuar me barre në gjendjen e mëparshme dhe pagimin e plotë të detyrimit të mbetur.
8. Vendosja e barres siguruese mbi pasurine e Z. Foto Zeneli sipas specifikimeve te kesaj Marreveshje, mbetet në fuqi deri ne dy vjet pas dates se nenshkrimit te kesaj akt marreveshje



Union Grup mund të heqë dorë me shkrim nga të drejtat mbi pasurine e regjistruar ne regjistrin e barreve siguruese.

#### NENI 10 FORCA MADHORE

Mospërmbushja e detyrimeve te kesaj marreveshje nga ana e njerës prej paleve nuk do te konsiderohet si shkelje e kesaj marreveshje per sa kohe kjo mospërmbushje vjen si pasoje e nje ngjarje te konsideruar Force madhore, ne rastin kur provohet se pala e prekur nga kjo ngjarje (a) ka marre te gjitha masat e arsyeshme parandaluese, si dhe te gjitha masat e nevojshme per te përmbushur kushtet dhe afatet e kesaj marreveshje, dhe (b) ka informuar palen tjetër ne menyre te menjehershme per ndodhjen e kesaj ngjarje.

Cdo periudhe kohe, brenda se ciles njera prej paleve, bazur ne kete marreveshje, do te ndermarre ndonje veprim, do te zgjatet ne nje menyre te barabarte me periudhen e kohës ne te cilen pala e kishte te pamundur te vepronte si pasoje e Forces Madhore.

#### NENI 11 LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI

11.1 Kjo Marreveshje rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

11.2 Cdo mosmarreveshje ndermjet Paleve ne lidhje me kete Marreveshje zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërt ajo mund t'i dërgohet për zgjidhje Gjykates se Shkalles se Pare e Rrethit Gjyqesor Tirane.

#### NENI 12

##### 12.1 TE NDRYSHME

Asnje amendament, modifikim, perfundim ose heqje dore prej ndonje nga klauzolat e kesaj Marreveshje, nuk do te jete ne asnje rast efektive po te mos jete me shkrim dhe e nenshkruar nga ose ne emer te seciles Pale.

Asnje ushtrim i vetem ose i pjesshem i nje te drejte ose rregullimi te parashikuar ne kete Marreveshje ose prej ligjit, nuk pengon ushtrimin e metejshem te te drejtes ose rregullimit ose ushtrimin e ndonje te drejte ose rregullimi tjetër.

##### 12.2 NDERPRERJA

Palet bien dakord te perpiqen te zevendesojne ndonje klauzole te pavlefshme ose pa force shtrenguese e cila, ne shkallen me te

máthe te mundshme, arrin qellimet e klauzoles te pavlefshme ose pa force shtrenguese.

### 12.3 KOPJET

Kjo Marreveshje hartohet ne 3 (tre) kopje, ne gjuhen Shqipe, nga nje per secilen pale dhe nje mbahet nga Noteri.

Secila prej tyre kur te behet dhe dorezohet do te quhet origjinal, por te gjitha keto kopje se bashku do te perbejne te njejtin instrument; faqet e nenshkruara mund te shkeputen prej kopjeve te vecanta te shumefishuara dhe te ngjiten ne nje kopje te vetme keshtu te gjitha faqet e nenshkruara jane te ngjitura fizikisht.

### 12.4 NJOFTIMET

Ndonje njoftim ose komunikim tjeter nen ose ne lidhje me kete Marreveshje (nje "Njoftim") do te jete me shkrim dhe ne gjuhen shqipe

### 12.5 DHENIA E TE DREJTAVE

Union Grup Sh.p.k. nuk mund te transferoje dhe te jape ndonje prej te drejtave te tij sipas kesaj Marreveshje, teresisht ose pjeserisht, pa patur me pare miratimin e shkruar te ACS, miratim qe nuk mund te mos jepet pa arsye.

### 12.6 SHPENZIMET DHE TAKSAT

Pervec rastit kur Marreveshja e parashikon ndryshe, secila pale do te paguaje vleren e saj ne lidhje me negociimet, pergatitjen, ekzekutimin dhe kryerjen prej saj te kesaj Marreveshje dhe per secilin prej dokumenteve te referuara ne te.

### 12.7 MARREVESHJA NE TERESI

Kjo Marreveshje perben nje marreveshje te tere dhe zevendeson cdo marreveshje te mepareshme mes te dy Paleve ne lidhje me cfare eshte objekt i kesaj Marreveshje

Kjo marreveshje u lexua perpara paleve, u cilesua e rregullt, dhe ne perputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire, dhe ishte nenshkruar nga palet perpara meje, Notere Armeta Levec

qe e vertetoj si ne perputhje me ligjin nr 7829 date 01.06.1994 per "Noteret Publike",

FOTO ZENELI

UNION GRUP SH.P.K.


Niko LEKA

TAKSA PULLES  
O PAGUAR

*Armeta Levec*  
*Niko Lecka*

## ANEKSET

- Aneksi A - Llogarite financiare
- Aneksi B - Pjeset e shtuara te kapitalit
- Aneksi D - Licensa e shoqerise per ushtrimin e veprimtarise
- Aneksi F - Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore  
leshuar nga organet tatimore
- Aneksi G - Padite gjyqesore
- Aneksi H - Prona e paluajtshme
- Aneksi I - Prona e luajtshme
- Aneksi J - Te drejta te pronesise industriale ose intelektuale
- Aneksi L - Marreveshjet e shoqerise
- Aneksi N - Kapitali hua, te marre borxhe ose hua te kesaj natyre
- Aneks M - Lista e te punesuarve ne shoqeri
- Aneks S - Statuti

A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke at the bottom.A handwritten signature in black ink, featuring a large, sweeping curve at the top and a more complex, looped structure below.



## ÇERTIFIKATË E KRYERJES SË REGJISTRIMEVE TË TJERA

Qendra Kombëtare e Regjistrimit vërteton se me date  është kryer regjistrimi i aplikimit:

regjistrime të tjera

(specifikoni llojin e ndryshimit)

-Pranimi në shoqëri të ortakut të ri shoqëri "Union Grup" sh pk  
-Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë "Albanian Courier Service" sh pk në vlerën 250 000 leke .  
-Ortake të shoqërisë "Albanian Courier Service" sh pk janë :  
-Foto Zeneli me 40 % të kuotave të kapitalit  
-Shoqëria "Union Grup" sh pk me 60 % të kuotave të kapitalit .  
-Administrator i shoqërisë është z.Foto Zeneli .

paraqitur nga

me numër çështje

Data e lëshimit

Emri, Mbiemri, Nenshkrimi  
(i nepunesit të sportelit)

AKT MARREVESHJE

Sot me date 23 Korrik, 2007, ne Tirane, u paraqiten  
përpara meje notere Enxheta Lles, anetare e  
Dhomës së Notereve, ne Tirane, palet qe do te lidhin kete  
kontrate:

Z. Foto Zeneli lindur me vitin 1965, ne qytetin e Vlores, i biri i Xhavitit dhe Saqinesë, banues ne Tirane person madhor me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr Z 1355632, banues ne Tirane, Shqiperi, referuar me poshte si "Garantuesi"

dhe

Union Grup sh.p.k., me qender ne Bulevardin Zogu I, Pallati Edi-Com 13 Katesh, Tirane, Shqiperi, regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane me Vendimin nr. 26016, date 25/06/2001 e perfaqesuar nga Z. Niko Leka ne cilesine e Administratorit te shoqerise.

Kjo akt marreveshje eshte ne vijim te akt marreveshjes se lidhur te cilesuar ne nenin 1 te saj.

**Neni 1**


Garantuesi dhe Union Grup sh.p.k. jane ne dijeni te faktit qe midis Albanian Courier Service sh.p.k. ketu e me poshte ACS, Union Grup sh.p.k. dhe Z. Foto Zeneli ka nje akt-marreveshje te dates 23 Korrik 2007 ne lidhje me blerjen e 60% te pjeseve te kapitalit te shtuar te shoqerise ACS.

**Neni 2**

Garantuesi garanton ACS dhe Union grup sh.p.k. qe ai, brenda dates 31 Dhjetor 2007, do te arketoje ne favor te ACS te gjitha detyrimet e te treteve ndaj ACS te paraqitura ne listen 1 "Kerkesa te arketueshme me 31 Maj 2007" si edhe do te shlyeje te gjitha detyrimet e ACS ndaj te treteve sipas listes 2 "Detyrime te pagueshme me 31 Maj 2007", lista keto bashkangjitur kesaj akt marreveshje.

**Neni 3**

Ne rast te mos permbushjes se detyrimeve te percaktuara ne nenin 2 te kesaj akt-marreveshje, ACS dhe Union grup sh.p.k. i lind e drejta te kerkoje nga garantuesi demshperblim per demin e shkaktuar.





Dem do te konsiderohet diferenca negative qe del si rezultat i shumes se arketimeve sipas listes 1 "Kerkesa te arketueshme me 31 Maj 2007" me shumen e pagesave sipas listes 2 "Detyrime te pagueshme me 31 Maj 2007", deri ne daten 31 Dhjetor 2007.

Per te garantuar ACS dhe Union Grup sh.p.k. per shlyerjen e demshperblimit , Garantuesi pranon te ngarkoje me barre siguruese ne favour te Union Grup sh.p.k., pjesen e tij prej 40% te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise ACS. Garantuesi duhet ta rregjistroje pjesen e tij te kapitalit ne Rregjistrin e Barreve Siguruese sipas procedurave ligjore ne fuqi, te cliruar nga cdo barre tjeter vec asaj per llogari te akt marreveshjes se dates 12 korrik 2007.

#### Neni 4

1. Ne cilesine e barredhenesit, Garantuesi, do te depozitoje prane Regjistrin Tregtar vendimin perkates te asamblese per ngarkimin e kesaj pasurie me barre shoqeruar edhe me nje kopje origjinale te kesaj Marreveshje;
2. Ne cilesine e barredhenesit Garantuesi detyrohet te mos kryejë asnjë procedurë apo veprim për kalimin ose tjetersimin e të drejtave të pronësisë, mbi pasurine e ngarkuar me barre apo cdo pasuri tjeter e lidhur me te , plotesisht ose pjeserisht, nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate dhe pa miratimin paraprak me shkrim nga ana e Union Grup Sh.p.k.
3. Në rast se garantuesi nuk e paguan demshperblimin per demin e shkaktuar si rezultat i mospermbushjes se nenit 2 te kesaj akt marreveshje , atëherë Union Grup sh.p.k. fiton të gjitha të drejtat për të proceduar menjehere për fitimin e pronësisë mbi pasuritë e ngarkuara me barre, në përputhje me dizpozitat e kesaj marreveshje qe perben titull ekzekutiv sipas nenit 510 e vijues te Kodit te Procedures Civile te Republikës se Shqipërisë dhe nenit 605 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.
4. Union Grup Sh.p.k. ose perfaqesuesi i saj ka të drejtë të bëjnë kqyrjen e pasurise se vendosur si barre siguruese dhe të bëjnë të gjitha verifikimet perkatëse në lidhje me gjendjen e tyre në vend e në regjistrat perkates.
5. Në qoftë se për cfarëdo shkak mbi një pjesë ose mbi të gjitha pasurinë e regjistruara me barre siguruese tagrat e pronësisë janë cënuar, shitur ose transferuar





pa pëlqimin e shprehur me shkrim të Union Grup sh.p.k., ky i fundit ka të drejtë të kërkojë në mënyrë të menjëhershme kthimin e pasurisë së ngarkuar me barre në gjendjen e mëparshme dhe pagimin e plotë të detyrimit të mbetur.

6. Vendosja e barres siguroese mbi pasurine e Garantuesit sipas specifikimeve te kesaj Marreveshje, mbetet në fuqi deri ne dy vjet pas dates se neneshkrimit te kesaj akt marreveshje
7. Union Grup mund të heqë dorë me shkrim nga të drejtat mbi pasurine e regjistruar ne regjistrin e barreve siguroese.

#### Neni 5

Kjo akt marreveshje rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Cdo mosmarreveshje midis paleve ne lidhje me kete marreveshje zgjidhet me mirekuptim ne rast te kundert ajo mund ti dergohet per zgjidhje Gjykates se Pare e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo marreveshje u lexua perpara paleve, u cilesua e rregullt, dhe ne perputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire, dhe ishte nenshkruar nga palet perpara meje, Notere Arbete Kocës, qe e vertetoj si ne perputhje me ligjin nr 7829 date 01.06.1994 "Per Noteret Publike",

FOTO ZENELI

UNION GRUP SH.P.K.



Niko LEKA  
Administrator

*Niko Leke*

*Foto Zeneli*

*Arbete Kocës*

*Kocës*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA  
TIRANE  
Nr. 640 Rep.

### VERTETIM

Sot ne daten Tete Shtator 2007 ( dymije e shtate), para meje noteres Eriketa Kokoli, notere ne Tirane , me Seli ne Rrugen “ Sami Frasheri”, u paraqit personalisht:

- 1- Ilna Shana, e bija e Ilias, lindur ne 29.11.1977, banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike, e njohur personalisht prej meje noteres, e cila me kerkoi qe te vertetoj me origjinalin : pasaporta e Foto Zenelit me numer Z 1355632.

Une noteri vertetoj se njesia eshte kopje e njejte me dokumentin original.


Vertetimi I dokumentit u be ne baze te nenit 56 te Ligjes 7829 date 01.06.1994 “ Per Noterine “ ( I ndryshuar” dhe udhezimit te Ministrit te Drejtesise Nr. 6291 date 17.09.2005.



NOTERE  
Eriketa Kokoli

A large, stylized handwritten signature in black ink, which appears to be 'Kokoli', is written over the printed name and extends across the bottom of the page.

ENVELOPE



Union Grup Sh.p.k

Bulevardi "Zogu I", Pallati Edi-Com 13 Katesh  
Tirane Shqiperi



## VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Sot ne daten 23/07/ 2007, u mblodh Asambleja e Ortakeve te shoqerise "Union Grup" sh.p.k., shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, zyra e rregjistruar e seciles ndodhet ne Tirane, ne adresen Bul,"Zogu I", Pallati Edi-Com 13 Katesh, Tirane, e perbere nga ortaket : Edmond Leka, Niko Leka, Gjergj Misha, Eduard Shima, Varuzhan Piranjani.

Pasi u verifikua pjesemarrja e ortakeve, rezultoi se jane te pranishemne mbledhje ortaket qe perfaqesojne 90% te pjeseve te shoqerise, te ciletkonfirmuan gjithashtu se jane njoftuar per zhvillimin e kesaj mbledhje sipas procedures te percaktuar ne ligj dhe ne Statut.

Pas shqyrtimit, Asambleja e Ortakeve mori vendim perkatesisht me rendin e dites si me poshte, me miratimin e te gjithe ortakeve te pranishem:

1. Nenshkrimin dhe shlyerjen e pjeseve te kapitalit themeltar te shtuar te shoqerise "Albanian Courier Service" sh.p.k

Asambleja e ortakeve vendosi temiratoje nenshkrimin dhe shlyerjen e zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise shqiptare me pergjegjesi te kufizuar "Albanian Courier Service" sh.p.k., me vlere nominale prej 150.000 Leke (njqindepesedhjetemije leke) kundrejt nje cmimi prej 10.300.000 (dhjetemilinetreqindmije leke) qe perbejne 60% (gjashtedhjete perqind) te kapitalit themeltar pas zmadhimit.

**2. Miratimi i marreveshjes midis Albanian Courier Service sh.p.k. dhe Union Grup sh.p.k.**

Asambleja e Ortakeve miraton Marreveshjen ndermjet Union Grup sh.p.k dhe Albanian Courier Service sh.p.k., date 23/07/2007.

**3. Autorizimi per ndjekjen e procedurave ligjore.**

Asambleja e Ortakeve vendos te autorizojë Z. Niko Leka ne ndjekjen e te gjitha procedurave ligjore te nevojshme dhe pergatitjen e te gjithë dokumentacionit perkates, si dhe te firmose dokumente apo shkresa zyrtare sikunder gjykohet e nevojshme per blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise "Albanian Courier Service" sh.p.k., nepermjet kontributeve ne para.

Asambleja e Ortakeve autorizon Z.Niko Leka per t'i perfaqesuar ata ne te gjitha veprimtarite me shoqerine "Albanian Courier Service" sh.p.k.


**4. Depozitimi i Vendimit**

Asambleja e Ortakeve vendos te depozitohet ky vendim si dhe Marreveshja si aneks i ketij vendimi, prane Zyres se Rregjistrimit Tregtar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane.


Per sa me siper u lexua ky vendim,i cili pasi lexohet, firmoset me vullnet te lire nga Ortaket.

Ortak


Edmond Leka




Eduard Shima



Niko Leka



Varuzhan Pirezani



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA

Nr. 3415 / Rep.

Nr. 2381 / Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne daten 23 Korrik 2007 ( dymije e shtate), ditën e hene, une notere Eriketa Kokoli, notere ne Tirane, me Seli ne Rrugen “ Sami Frasheri” vertetova firmat e vena ne Vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise “ UNION GRUP”SHPK :

**1-Niko Leka**, I biri I Vlashit dhe I Margarites, lindur ne Tirane me 31 Mars 1961, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike, mbajtes I pasaportes me numer Z 0229907


**2. Edmond Leka**, I biri I Vlashit dhe I Margarites, lindur ne Tirane me 17 Maj 1963, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike, I njohur personalisht prej meje noteres.

**3.Varuzhan Piranjani**, i biri i Vahramit, lindur ne 22 Mars 1957, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike, i njohur personalisht prej meje noteres.

**4.Eduart Shima**, i biri i Fejziut, lindur ne Tirane me 6 Nentor 1960, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike, mbajtes si pasaporte sme numer Z 0785825.

Une noteri pasi e gjeta conform nenit 39 te Ligjes 7929 date 1 Qershor 1994 “ Per Noterine” e vertetova si me poshte.

NOTER  
Eriketa Kokoli



Albanian Courier Service Sh.p.k  
Rruga Kajo Karafili, Pall.8/1  
Tirane Shqiperi



**VENDIM I ORTAKUT TE VETEM  
Nr. 2007/1**

Sot ne daten 12 Korrik 2007, ne baze te Nenit 12 te Statutit te Shoqerise dhe Nenit 61 e vijues te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare ", Ortaku i Vetem Themelues i Shoqerise "Albanian Courier Service" sh.p.k., zyra e rregjistruar e se ciles ndodhet ne Tirane, ne adresen Rruga Kajo Karafili, Pall 8/1 Tirane, mori vendim perkatesisht me rendin e dites si me poshte:

**1. Zmadhimi i kapitalit themeltar nepermjet kontributit ne para.**

Ortaku i Vetem vendos te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqersie "Albanian Courier Service" sh.p.k me vleren nominale prej 150.000 Leke (Njeqindepesedhjetemije Leke) nepermjet nenshkrimit te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para.

**2. Hyrja ne shoqeri e Ortakut te ri**

Ortaku i Vetem vendosi per pranimin ne Shoqeri te ortakut te ri shoqerine "Union Grup" sh.p.k., perfaqesuar nga Administratori i saj Z. Niko Leka. Ortaku i ri kontribuon ne kapitalin thyemeltar te shoqerise nepermjet kontributit ne para ne vleren nominale 150.000 Lek (Njeqindepesedhjetemije Leke) si dhe me nje prim mbi kapitalin ne vleren 10.150.000 Leke (Dhjetemilionnjeqindepesedhjetemije Leke).  
Te gjitha pjeset e reja te kapitalit themeltar nenshkruhen ne teresine e tyre nga ortaku i ri dhe shlyhen krejtesisht nga ai.

**3. Kapitali themeltar dhe ortaket e shoqerise " Albanian Courier Service" sh.p.k.**

Ortaku i vetem vendos qe pas zmadhimit, kapitali themeltar i shoqerise "Albanian Courier Service" Sh.p.k eshte 250.000

leke (Dyqindepesedhjetemije Leke) i ndare ne 250 (dyqindepesedhjete) pjese me vlefte nominale 1.000 leke (njemije leke) secili qe zoterohet nepermjet ortakeve si me poshte vijon:

- a) Ortakut Union Grup Sh.p.k., I perkasin 150 (njeqindepesedhjete) pjese te kapitalit themeltar qe korrespondojne me 60% te kapitalit themeltar te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "Albanian Courier Service" Sh.p.k.
- b) Ortakut **Foto Zeneli**, I perkasin 100 (njeqind) pjese te kapitalit themeltar qe korrespondojne me 40% te kapitalit themeltar te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "Albanian Courier Service" Sh.p.k

#### **4. Administratori i shoqerise**

Caktohet Z. Foto Zeneli si Administrator i shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "Albanian Courier Service" sh.p.k.

#### **5. Miratimi i Marreveshjes ndermjet Union Grup sh.p.k dhe Albanian Courier Service sh.p.k.**

Ortaku i Vetem miraton Marreveshjen ndermjet Union Grup sh.p.k dhe Albanian Courier Service sh.p.k te dates 12 Korrik 2007.

#### **6. Depozitimi i Vendimit**


Ortaku I vetem vendos te depozitohet ky vendim dhe Marreveshja e si aneks I ketij vendimi , prane Zyres se Rregjistrit Tregtar ne gjykatën e Shkalles se Pare Tirane dhe ngarkon Administratorin, Z. Foto Zeneli per ndjekjen e procedurave perkatese.

Te gjitha ndryshimet per shlyerjen e pjeseve te kapitalit themeltar dhe per depozitimimin e fondeve pasqyrohen ne statutin e Shoqerise.

Per sa me siper u hartua ky vendim, I cili u firmos me vullnet te lire nga Ortaku I Vetem.

Ortak i Vetem

FOTO ZENELI





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA

Nr. 3716 Rep.  
Nr. 2382/3 Kol.



VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne daten 23 Korrik 2007 ( dymije e shtate), ditën e hene, une notere Eriketa Kokoli, notere ne Tirane, me Seli ne Rrugen “ Sami Frasheri” vertetova firmen e vene ne Vendimin e Ortakut te Vetem te Shoqerise “ Albanian Courier Service SHPK. Te

**1- Foto Zeneli**, i biri i Xhavitit, lindur ne vitin 1965, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike, mbajte si pasaportes me numer Z 1355632.

Une noteri pasi e gjeta conform nenit 39 te Ligjes 7929 date 1 Qershor 1994 “ Per Noterine” e vertetova si me poshte.

NOTER  
Eriketa Kokoli


## AUTORIZIM

